



KOMUNA E MALISHEVËS



BULETINI

Nr. 90-Dhjetor 2010 ZYRA PËR INFORMIM - <http://kk.rks-gov.net/malisheve/www.malisheva-komuna.org>





Përmbajtja:

KEK-u kthen shtatë fshatra në furnizim nga Malisheva	3
PDK del fituese në të gjitha pikat e votimit në Malishevë	3
U zbulua pllaka e shtëpisë kazermë në Mleqan.....	4
Vit i mbarë me të hyrat vetanake	5
KKSB: Situata e qetë dhe stabile.....	6
Kryetari mbajti takimin e dytë me qytetarë për vitin 2010.....	7
Komuna dhe bizneset lokale ndihmojnë 235 familje	9
Shpallen më të mirët e vitit në kulturë, rini dhe sport	10
Malisheva përfituese e programit të USAID-it, Iniciativa për Komunat Demokratike dhe Efektive (DEMI)	11
Me rastin e ndërrimit të viteve Kryetari Kilaj vizitoj familjet e dëshmorëve	13



KEK-u kthen shtatë fshatra në furnizim nga Malisheva

Malishevë, 1 dhjetor

Falë një investimi kapital nga ana e Koorporatës Elektroenergjetike të Kosovës (KEK), shtatë fshatra të Malishevës, të cilat deri më tani janë furnizuar me energji elektrike nga Klina, prej sot, do të furnizohen nga Malisheva, me çka përmirësohet furnizimi me energji elektrike për këto fshatra.

Përfitues të këtij rrjeti të ri, janë Bubaveci, Kijeva, Mleqani, Llozica, Balinca, Plloqica, dhe Golluboci.

“Kemi bërë përpjekje, një kohë të gjatë dhe është bërë një punë e mirë dhe një nga projektet më kapitale në fushën e energjisë në Malishevë. Prandaj, me këtë investim po hapet porta për furnizim më të mirë me energji elektrike”, tha kryetari i komunës z. Isni Kilaj, me rastin e lidhjes së rrjetit të këtyre fshatrave me furnizim nga Malisheva.

“Jo të gjitha problemet do të mund zgjidhen, por me një angazhim dhe kryerje të obligimeve, edhe KEK-u do të investoj në përmirësimin e rrjetit, por përmirësimi do të jetë i dukshëm dhe ju do ta përjetoni këtë”, tha Kilaj.

“Kjo është një vepër e madhe e KEK-ut, dhe me insistimin e komunës, ju prej sot do të keni furnizim më të mirë me energji elektrike”, tha në fund kryetari Kilaj.

“Janë investuar rreth një milion euro në rregullimin e rrjetit dhe janë bërë pesë muaj punë efektive, deri në rregullimin e tërësishëm”, tha përgjegjësi i njësies së KEK-ut në Malishevë Qamil Hoti. “Përmirësimi do të jetë njëqind për qind, dhe këta konsumator, më nuk do të përballen me dëmtimin e pajisjeve të tyre, por edhe furnizimi do të jetë shumë më i mirë”, tha Hoti, duke folur për përfitimet që do ti kenë konsumatorët e këtyre shtatë fshatrave.

PDK del fituese në të gjitha pikat e votimit në Malishevë

Malishevë, 13 dhjetor

Në të gjitha pikat e votimit, 27 qendra dhe 65 vendvotime në Malishevë, janë mbajtur zgjedhjet parlamentare në nivel vendi, me ç’rast çdo gjë ka shkuar konform ligjeve në fuqi dhe rregullave të KQZ-së.

Sipas kryetarit të komunës së Malishevës, z. Isni Kilaj, njëherësh edhe kryetar i PDK-së në Malishevë, çdo gjë ka shkuar në rregull, në përjashtim të disa incidenteve të ndodhura pasi ka përfunduar procesi zgjedhor.

Kryetari Kilaj, ka deklaruar se Partia Demokratike në Malishevë, ka fituar bindshëm në të gjitha qendrat e vendvotimit në këtë komunë, ndërsa pritet që të përfaqësohet me disa kandidatë në Parlamentin e Kosovës.

Në Malishevë, fituese e zgjedhjeve ka dalë Partia Demokratike e Kosovës, me 64.9 përqind të votave, ndërsa është për tu vlerësuar edhe dalja në zgjedhje e afër 60 % e votuesve.

U zbulua pllaka e shtëpisë kazermë në Mleqan

Malishevë/Mleqan, 15 dhjetor



Sot në fshatin Mleqan, u bë zbulimi i pllakës së shtëpisë kazermë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, shtëpi e cila ishte shtab i njësisë operative “Lumi” të UÇK-së, ndërsa zbulimi i pllakës, u bë në përvjetorin e dymbëdhjetë të rënies së dëshmorit nga kjo familje, Hazir Kryeziu.

Pllakën përkujtimore e zbuluan, Kryetari i Komunës së Malishevës,

z. Isni Kilaj, Besim Kryeziu, anëtar i familjes, Enver Hoti ish epror në njësinë operative “Lumi” dhe Fatmir Shurdhaj, përfaqësues i Shoqatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së.

“Ndihehem shumë i emocionuar, pasi sot, pas kaq viteve ne përkujtojmë dëshmorin e kombit Hazir Kryeziu dhe këtë anë ku ka operuar Ushtria Çlirimtare e Kosovës dhe ku

është dhënë një kontribut i madh në luftën për liri”, tha kryetari Kilaj. Duke përkujtuar dëshmorin Hazir Kryeziu, kryetari i komunës, z.Isni Kilaj tha se “të përkujtohen dëshmorët është nder”.

Në këtë ceremoni, fjalime rasti kanë mbajtur edhe Enver Hoti dhe Fatmir Shurdhaj.

Hazir Kryeziu ra heroikisht së bashku me 41 luftëtarë të UÇK-së më 14 dhjetor 1998, në një pritë nga forcat serbe, afër kufirit Kosovë-Shqipëri.

Vit i mbarë me të hyrat vetanake

Malishevë, 20 dhjetor

“Ky vit ka qenë i mbarë nga të hyrat vetanake të komunës”, ka deklaruar kryetari i komunës, z.Isni Kilaj, në mbledhjen e radhës së Bordit të Drejtorëve, duke folur për punën e Qeverisë Komunale, gjatë vitit 2010.

Në këtë mbledhje, kryetari Kilaj, ka kërkuar nga përgjegjësit e drejtorive komunale, që t’i përfundojnë raportet e punës për këtë vit, si dhe nga Drejtoria e Urbanizimit, ka kërkuar që të bëhen pranimet teknike të projekteve të realizuara gjatë këtij fund viti.

Kryetari i komunës, ka vlerësuar furnizimin me lëndë djegëse për ngrohje në të gjitha shkollat e komunës sonë, si dhe ka urdhëruar edhe furnizimin me derivate për ngrohje për Qendrën e Banimit Social në Malishevë dhe të Handikos-it. Ndërkohë ka kërkuar nga kompanitë përgjegjëse, që të jenë efektive për pastrimin e borës nga rrugët, në tërë territorin e komunës.





Çështje tjetër me rëndësi, në këtë mbledhje, ishte edhe përgatitja për ndihma me pako ushqimore, për kategoritë e caktuara sociale, të cilat së bashku edhe me Komunitetin e Bizensit, do të ndihmohen për këtë fund vit.

Po ashtu është kërkuar nga Drejtoria e Shërbimeve Publike që të bëj përgatitjet e duhura për dekorimin e qytetit me rastin e festave të fundvitit.

Ndërsa drejtori për shëndetësi, z.Skënder Hoti, ka njoftuar, se në bashkëpunim me Drejtorinë për Buxhet dhe Financa si dhe Ministrinë përkatëse, është kryer obligimi për premtimin e dhënë ndaj punëtorëve të shëndetësisë për pagesën prej 44 euro, për katër muaj.

KKSB: Situata e qetë dhe stabile

Malishevë, 22 dhjetor

Në mbledhjen e nëntë të radhës, dhe e fundit për këtë vit, Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB), e ka vlerësuar të qetë dhe stabile situatën e sigurisë së përgjithshme në territorin e komunës së Malishevës, përderisa për Policinë e Kosovës, vazhdon të jenë shqetësuese aksidentet në trafik.

Të gjithë anëtarët e KKSB-së, e vlerësuan të qetë situatën e sigurisë, përderisa ka raportuar para KKSB-së, drejtori i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Siguri, z.Halit Zogaj, sipas të cilit, shërbimi i zjarrfikësve, kanë intervenuar në 16 raste të ndryshme.

Komandanti i stacionit policor në Malishevë, togeri Bekim Begaj, bazuar në raportin e policisë, ka theksuar se me gjithë disa incidente gjatë ditës së zgjedhjeve, të cilat janë evituar, nuk ka pasur ngjarje, të cilat e prishin situatën e sigurisë në Malishevë.

Sipas togerit Begaj, shqetësuese vazhdon të mbetet siguria në trafik, ku gjatë këtij viti, ka pasur më shumë aksidente me fatalitet, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. “Përderisa më 2009, kemi pasur tri raste të aksidenteve me fatalitet në tri aksidente trafiku, gjatë këtij viti, janë regjistruar katër raste të aksidenteve me fatalitet, ku kanë humbur jetën gjashtë persona”, ka raportuar togeri Begaj.

Po sipas Policisë së Kosovës, janë shtuar masat e sigurisë, në prag të festave të fundvitit, për shkak të pranisë më të madhe të numrit të veturave në komunikacion, ndërsa vitin që po e lëmë, e ka vlerësuar në përgjithësi si vit të qetë dhe pa indikacione për destabilizim, sa i përket situatës së sigurisë në komunë.

Sigurinë e përgjithshme në Malishevë, të qetë dhe stabile, e ka vlerësuar edhe zyrtari i lartë i Ministrisë së Punëve të Brendshme, Imer Thaçi, përgjegjës në Departamentin për

Siguri në Bashkësi, në MPB, përderisa ka vlerësuar lartë edhe punën e KKSB-së në Malishevë dhe për arritjet pozitive në disa segmente të sigurisë.

Thaçi, ka njoftuar se MPB, është në përfundim e sipër të strategjisë për sigurinë në bashkësi.

Kryetari mbajti takimin e dytë me qytetarë për vitin 2010

Malishevë, 23 dhjetor



Kryetari i Komunës, z.Isni Kilaj, mbajti takimin e dytë me qytetarë për këtë vit. Në këtë mbledhje publike, kryetari, fillimisht i njoftoi qytetarët me realizimin e projekteve kapitale në Komunën e Malishevës, gjatë vitit 2010 dhe projektet që do të realizohen gjatë vitit 2011 të përfshira në buxhetin komunal, si dhe me projektet tjera, të cilat do të mund të realizohen përmes donatorëve.

Projektet e realizuara, gjatë vitit 2010 janë:

1.	Shkolla e mesme profesionale	4 500 000 €
2.	Shkolla e Mleqanit	850 000 €
3.	Shkolla në Senik	350 000 €
4.	Renovimi i gjimnazit “A.Frashëri”	80 000 €
5.	Tri fusha të zportit në shkolla fillore	90 000 €
6.	Kolektori i ujërave të zeza	450 000 €
7.	Salla e sporteve	1 850 000 €
8.	Shtëpia e kulturës	850 000 €
9.	Shtrati i përroskës	100 000 €
10.	Ujësjiellësi Damanek, Bubël dhe Qupevë	350 000 €
11.	Ujësjiellësi në Turjakë	340 000 €



12. Mirëmbajtja verore	120 000 €
13. Asfalti me trotuar, ndriçim Malishevë –Burim	870 000 €
14. Asfal, trotuar, ndriçim te shkolla profesionale	270 000 €
15. Investime nga KEK, larg. për Kijevë	2 000 000 €
16. Ndihma për ët pastrehët	95 000 €
17. Ndihma për të varfrit 20 000 kg miell	
18. Ndihma në barëra	15 000 €
19. Ndihma për familje të dëshmorëve	10 000 €
20. Asfaltimi i rrugës në Temeqinë	120 000 €
21. Trotuaret në Dragobil	30 000 €
22. Trotuar në Mirushë	45 000 €
23. Rrugë me zhavor	10 000 €
24. Trotuar në Kijevë	30 000 €
25. Trotuar në Llapqevë	24 000 €
26. Miniparku në Malishevë	30 000 €

Ndrësa projektet për vitin 2011, brenda buxhetit komunal dhe mjetet të siguruar për investime, janë :

1. Ndërtimi i fushës së futbollit	200 000 €
2. Financim në Bujqësi	50 000 €
3. Financimi i Shkollës Profesionale	50 000 €
4. Ndërtimi i shtëpive prë të pastrehë	50 000 €
5. Financimi i Shtëpisë së Kulturës	50 000 €
6. Financimi i Pallatit të Sporteve	50 000 €
7. Rrjete kanalizimi	300 000 €
8. Asfaltime të rrugëve	400 000 €
9. Shkolla në Vërmicë	200 000 €
10. Mirëmbajtja e rrugëve	40 000 €
11. Bashkëfinancim	200 000 €
12. Shkolla në Bellanicë	100 000 €
13. Kolektori i ujërave të zeza	187 752 €
14. Aneksi i shkollës në Marali	60 000 €
15. Renovim i kullave	40 000 €
16. Ujësjiellësi në Malishevë	50 000 €
17. Gjellbrim dhe rregullim te liqeni	100 000 €
18. Asfaltim i rrugëve në qytet	200 000 €
19. Nënkalim në Astrazup	60 000 €
20 Trotuar në fshatra	200 000 €

Të gjitha këto, kapin një shumë prej 2 587 752 euro investime kapitale për vitin 2011



Po ashtu në vitin 2011 do të ndërtohet edhe qendra për biznes, një projekt tashmë i nënshkruar me Agjencionin për Zhvillimin Rajonal (AZHR).

Ndërsa lista e projekteve prioritare për vitin 2001, jashtë buxhetit të komunës, është:

1.	Shpella e fladit në Panorç	400 000 €
2.	Kolektori i ujërave të zeza	1 000 000 €
3.	Shtrati i lumit Mirusha	300 000 €
4.	Tregu të "Fusha e Begut"	500 000 €
5.	Shkolla në Carrallukë	450 000 €
6.	Shkolla në Gurishtë	350 000 €
7.	Shkolla në Damanek	400 000 €
8.	Shkolla në Carrallukë (naltë)	450 000 €
9.	Aneksi i shkollës në Banjë-Begaj	150 000 €
10.	Oborri i shtëpisë së kulturës	100 000 €
11.	Oborri i Pallatit të Sportit	100 000 €
12.	Renovimi i shkollës në Drenoc	180 000 €
13.	Rruga e transitit	3 000 000 €
14.	Shkolla në Shkozë	450 000 €

Për këto të fundit, kryetari Kilaj u shpreh i sigurt në gjetjen e fondeve për vitin e ardhshëm për realizimin e këtyre prioriteteve.

Pas këtyre, prezantimeve, kryetari Kilaj, ka bashkëbiseduar me qytetarë, nga të cilët ka dëgjuar hallet me të cilat ata përballen dhe për çështje tjera që lidhen me kompetencat e kryetarit të komunës dhe në të gjitha pyetjet, kryetari është përgjigjur, duke i siguruar ata, se gradualisht, do të zgjidhen të gjitha problemet, që ata kanë.

Ajo që vlen të përmendët, është se shumica e atyre që kanë marrë fjalën, kanë falënderuar kryetarin dhe komunën, për investimet e bëra, përderisa, kërkesa dominonte ishte, nevoja e ndërtimit të trotuareve nipër fshatra, tash, pasi rrugët janë asfaltuar.

Komuna dhe bizneset lokale ndihmojnë 235 familje

Malishevë, 28 dhjetor

Në kuadër të programit vjetor të komunës, kryetari i Malishevës, z.Isni Kilaj, në bashkëpunim me komunitetin e biznesit, edhe në këtë fundvit, duke filluar nga sot, do të ndihmojnë, së paku 235 familje, përfshirë këtu familjet e dëshmorëve, dhe familje të tjera në asistencë sociale dhe gjendje të rëndë ekonomike.

“Komuna, do të ndihmoj me pako ushqimore në vlerë prej 70 euro, përkatësisht 50 euro, 75 familje të dëshmorëve, si dhe 100 familje tjera në asistencë sociale” tha kryetari i komunës, z.Isni Kilaj. “Aksionit tradicional të komunës, i është bashkuar edhe komuniteti i bizneseve në Malishevë, të cilët kanë siguruar 60 pako ushqimore për familje tjera në nevojë, në vlerë prej 50 euro, apo në total janë tre mijë euro të komunitetit të biznesit”, tha kryetari Kilaj.

“ Gjatë këtij viti, kemi shpërndarë 20 mijë kilogram miell për familjet që kanë nevojë, ndërsa ky program do të vazhdoj edhe me tutje”, tha në fund kryetari I komunës së Malishevës, z. Isni Kilaj, duke shprehur gatishmërinë institucionale për t’iu dale në ndihmë familjeve me gjendje të rëndë ekonomike.

Shpallen më të mirët e vitit në kulturë, rini dhe sport

Malishevë, 28 dhjetor

Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport, ndua shpërblime dhe mirënjohje, për më të mirët në këto fusha, bazuar në sukseset e arritura, gjatë vitit 2010.

“Ju falënderoi të gjithë juve që keni dhënë kontribut për zhvillimin e sportit, kulturës dhe rinisë”, tha nënkryetari i komunës, z.Rexhep Mazreku”, në fjalën e rastit dhe premtoi, që “në vitin 2011, kultura, rinia dhe sporti, do të kenë kushte më të mira infrastrukturore për zhvillimin e aktiviteteve të tyre”.



Më të mirët e vitit, në Kuluturë, Rini dhe Sport:

Lexuesit më të mirë: Liridon Sopaj, Arbenita Mazreku, Majlind Samadraxha, Vlorian Paçarizi, Liridona Sertolli, Bashkim Sopaj, Albin Gashi, Diamant Gashi dhe Rilinda Bacaliu.

Në kulturë: SHKA “Sali e Feriz Krasniqi”, Shoqata për kulturë dhe letërsi “Tafil Kelmendi”, pikturë Albulena Ahmeti, poezi Izet Shala dhe muzikë Sylejman Krasniqi.

Rini: Qendra Rinore, Këshilli i Veprimtari Rinor Lokal dhe Fatlind Krasniqi-aktivist i dalluar.

Sport: Atletikë: Florian Begaj- reprezentues i Kosovës, me 7 medalje ari, 4 të argjenda dhe 3 të bronzta, medalje e artë në kampionatin gjithëkombëtar në Tiranë të moshës U16, e bronzte për moshat U18. Atleti i dytë më i mirë në nivel vendi në kategorinë e juniorëve; Hendboll: Ryve Statovci-klubi i hendbollit “Llapusha”; Futbolliste: Arjana Mazreku- klubi i futbollit për femra “Malisheva”; Futbollisti: Butrint Bacaliu- KF “Iliria”-Kijevë; Postmortum: Sahit Hoxha-për kontributin e dhënë në sportin e Malishevës; Shenjëtari: Haxhi Berisha; Shah: Avdulla Telaku; Not: Monika Shurdhaj; Shpresa e futbollit: Mendurim Hoti; Punëtori më i mirë sportiv: Bekim Ullur; Gjyqtari i vitit: Afrim Dobruna; Veteran i sportit: Hasim Mazreku; Trajneri i vitit: Ardian Telaku Klubi i vitit: Klubi i notit “Besa” – Banjë; Sportisti i vitit: Monika Shurdhaj.

Malisheva përfituese e programit të USAID-it, Iniciativa për Komunitet Demokratike dhe Efektive (DEMI)

Malishevë, 29 dhjetor



Malisheva, është njëra ndër komunitet përfituese të projektit të USAID-it, Iniciativa për Komunitet Demokratike dhe Efektive (DEMI), një program tre vjeçar i USAID-it. Këtë lajm, përfaqësuesit e USAID-it, ia kanë konfirmuar sot kryetarit të komunës, z.Isni Kilaj, në një takim të mbajtur në zyrën e tij.

Fillimisht kryetari Kilaj,



falënderoi përfaqësuesit e USAID-it për vizitën, ndërsa bashkëpunimin me USAID-in e quajti “bashkëpunim i mirë në fushën e qeverisjes së mirë, për çka, edhe jemi shpërblyer me grante stimuluese nga ana e USAID-it”. “Përzgjedhja juaj na shtynë të bashkëpunojmë edhe më shumë, për performacë më të mirë të komunës”, tha kryetari Kilaj, duke e falënderuar USAID-in, për përzgjedhjen e Malishevës, në këtë projekt të tyre.

Veton Canaj dhe Danielle Spinard nga USAID-i, thanë, se “Malisheva e ka merituar grantin, pasi i ka përmbushur kriteret që të jetë përfituese e këtij projekti, trevjeçar”, dhe njoftuan kryetarin, për hapat e mëtejshëm, që kanë të bëjnë me vlerësimin e gjendjes dhe nevojave të komunës.

Kurse Ginka Kapitanova, nga Urban Institute, implementues të projektit, e ka njoftuar kryetarin me pesë objektivat e këtij programi, që do të realizohen, me qëllim që të identifikohen dhe arrihen rezultate kyçe në qeverisje efektive, rritje të besimit në Qeveri, përmirësim të shërbimeve lokale, zhvillim lokal më të fuqishëm dhe përfshirje më të madhe të qytetarëve (të rinjve) në vendimmarrje. Objektivat e këtij projekti janë: Forcimi i Administratës Komunale, Fuqizimi i Kuvendeve Komunale, Rritja e angazhimit të qytetarëve në qeverisjen komunale, Vlerësimi i performacës për ofrimin e shërbimeve komunale, Promovimi i Zhvillimit Ekonomik Lokal dhe Fondet stimuluese dhe mbështetëse.

Iniciativa për Komunitet Demokratike dhe Efektive, është projekt trevjeçar i USAID-it, dedikuar komunave të Kosovës, udhëheqësve dhe qytetarëve, për të promovuar qeverisje të mirë.

Memorandumi i bashkëpunimit, midis Komunës së Malishevës dhe USAID-it, për këtë projekt, pritet të nënshkruhet në mesin e janarit 2011.

Me rastin e ndërrimit të viteve Kryetari Kilaj vizitoj familjet e dëshmorëve

Malishevë, 31 dhjetor



Në ditën e fundit të vitit, Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Isni Kilaj, ka vizituar disa nga familjet e dëshmorëve, për t’ju uruar Vitin e Ri 2011 dhe për të qenë afër tyre, në shenjë respekti për kontributin e dhënë për çlirimin e vendit.

“Unë vetëm dëshrioj që tu uroj festën e ndërrimit të motmoteve, familjarëve të dëshmorëve, në shenjë respekti për kontributin e dhënë për lirin që ne sot e gëzojmë dhe mundësinë që kemi, falë gjakut të tyre, t’i festojmë këto festa”, ka thënë kryetari Kilaj.

“Ne kemi nevojë për vizitat e juaja, si kryetar komune, që në këso raste, të jeni bashkë me ne dhe ky është nderimi që ju na bëni neve si familje, për çka ju falënderojmë, që edhe ditën e fundit të vitit, e kaloni me neve”, ishin disa nga fjalët që i drejtonin kryetarit Kilaj, familjarët, prindërit dhe fëmijët e dëshmorëve.